



**Ndryshimi i Marrëveshjes Bashkëpunimit në mes Komunës së Gjakovës dhe
N.P.L "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Gjakovë me numër 01Nr.413/01-9080**

E lidhur në Gjakovë me datë:04.11.2020 në mes të palëve:

1. Komuna e Gjakovës të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini, në tekstin vijues: Komuna.
2. N.P.L "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Gjakovë të cilën e përfaqëson Kryeshefi Ekzekutiv z. Flamur Bicurri, në tekstin vijues: "Stacioni i Autobusëve".

Neni 1

Pas kërkesës nga pala në marrëveshje, N.P.L "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Gjakovë, palët u pajtuan që të ndryshohet marrëveshja me numër 01Nr.413/01-9080.

Neni 2

Kjo marrëveshje ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e marrëveshjes bazë për bashkëpunim me numër 01Nr.413/01-9080, pas paragrafit 2.3 të nenit 2 të marrëveshjes bazë shtohet edhe paragrafët si në vijim:

- 2.4. *Vlera e tarifave për pagese për mjetet motorike për veturat private kostoja është 5.00 euro.*
- 2.5. *Vlera për tarifat për pagës për kombibusë ose furgona privat kostoja mujore është 10.00 euro.*
- 2.6. *Vlera për tarifat për pagesë për autobusë, kostoja mujore është 30.00 euro*
- 2.7. *Vlera e tarifave për gjësendet tjera do të kategorizohet në bazë të llojit të hapësirës si 0.50 euro neto për m² jashtë mbulojës dhe nga 1.00 euro për m² nën mbulojë*

Neni 3

Në nenin 3 të marrëveshjes bazë shtohet paragrafët si në vijim:

- 3.2 Përfaqësuesit e drejtorive të cekur si në paragrafin 1 të nenit 3 të marrëveshjes bazë, obligohen që të përgatitin raport mujor vetëm për drejtorit përkatës.

Neni 4

Palët nënshkruese të këtij Marrëveshje e konfirmojnë vullnetin e lirë për realizimin e të gjitha detyrimeve, sipas afateve dhe në harmoni me përgjegjësitë dhe kriteret e përshkruara në këtë ndryshim të marrëveshje, si dhe të marrëveshjes bazë, ndërsa lidhur me mospajtimet eventuale në këtë ndryshim të marrëveshje do të zgjidhen në konsultim me mes palëve.

Ky ndryshim i marrëveshje bashkëpunimi është përpiluar në 2 kopje identike, prej të cilave nga një kopje iu dorëzohen palëve dhe i njëjti hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

P A L Ë T

Kryetari i Komunës Gjakovës

Ardian Gjini



Kryeshefi Ekzekutiv

Flamur Bicurri